



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Ministria e Financave dhe Ekonomise  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA E DOGANËS KAPSHTICË

Nr. 644/5 Prot

Kapshtice, datë 29/07/2022

LËNDA: Kërkesë për shpallje publike

DREJTUAR: DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEPARTAMENTI I ANALIZAVE DHE APOSTERIORIT  
SEKTORI I MONITORIMIT TË BORXHIT / TIRANE

DREJTUAR: DREJTORIA E BURIMEVE MBËSHTETËSE ✓

Adresa: Tiranë, Kashar Mëzez, Lagjia Fushë Mëzez, autostrada Tiranë-Durrës, km 1,  
Qendra "Pajtoni Bussines Center", kati 5.

Bazuar në nenin 96 të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "Kodi Doganor Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe pikës 4 të nenit 162 të Ligjit Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodit të Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë", 4. "...organi publik publikon aktin në faqen e tij të internetit dhe ..." kërkojmë shpalljen publike për *vendimin për rikuperim me force të borxhit doganor, per* ;

**Subjekti:** "B BC DY" me NIPT M02110023P  
**Vendimi:** Nr 644/5 date 29/07/2022  
**Detyrimi:** 10.1014 leke detyrime doganore.

Lutemi qe për vazhdimin e procedurave ligjore për rikuperimin e borxhit doganor është domosdoshmëri data e shpalljes publike (bashkëlidhur vendimi Nr 644/5 date 29/07/2022)

Ju falenderojmë për bashkëpunimin.

KRYETARI I DEGES SE DOGANES KAPSHTICË

HERKUL MARKO





Drejtoria e Doganës Kapshticë  
Nr. 644/3 data 10/05/2022  
Date

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ministria e Financave dhe Ekonomise  
DREJTORIA E PERGJITHESHME E DOGANAVE

Dega e Doganës Kapshticë

Nr. 644/3 Prot.

Kapshticë, më 29/07/2022

VENDIM

**Për rikuperimin me forcë të borxhit doganor të subjektit debitorit "B BY DC" identifikuar me NIPTM02110023P**

Dega e Doganës Kapshticë, me Vendimin Nr 92 datë 10/02/2022 ka vendosur kontabilizimin dhe arkëtimin e borxhit doganor në shumën totale 10.014 leke detyrime dhe kamat vonesat përkatëse të cilat rillogaritën.

Ky vendim i është komunikuar debitorit "B BY DC" identifikuar me NIPTM02110023P më njoftimin Nr 644/3 date 10/05/2022 ne adresen e deklaruar nga subjekti, shkrese e cila eshte kthejr me shenimin i panjohur, vendim per te cilin nuk eshte shlyer detyrimi doganor sipas vendimit të sipërpërmendur.

Me shkresën Nr. 644/5 date 06.07.2022, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, referuar nenit 162 të ligjit Nr.44/2015 datë 30.04.2015 "Kodit të Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë" Dega e Doganës Kapshticë, ka bërë kërkesë për shpallje publike të vendimit administrativ nr. 92 datë 10.05.2022 pranë Bashkisë Tiranë, Njesia administrative Nr 2.

Me shkresën nr.25525/1 prot, datë 20.07.2022 (protokolluar pranë Degës së Doganës Kapshticë me Nr. 644 prot., datë 22.07.2022) Bashkia Tiranë, Njësia bashkiake Nr 2, konfirmon se shpallja për subjektin, është afishuar në këndin e njoftimeve me datën 13.07.2022 dhe njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes, sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 162, të ligjit të sipërcituar.

Nr. 644/5 date 06.07.2022, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, referuar nenit 162 të ligjit Nr.44/2015 datë 30.04.2015 "Kodit të Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë" Dega e Doganës Kapshticë ka bërë kërkesë për shpallje publike të Vendimit administrativ nr. 92 datë 10.05.2022 pranë Drejtorise Rajonale Tatimore Tirane.

Me shkresën nr.19336/1 prot, datë 20.07.2022 (protokolluar pranë Degës së Doganës Kapshticë me Nr. 644 prot., datë 26.07.2022) Drejtoria Rajonale Tatimore Tirane, konfirmon se shpallja për subjektin është afishuar në këndin e njoftimeve me datën 15.07.2022 dhe njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes, sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 162, të ligjit të sipërcituar.

Me shkresën Nr.644/7 prot., datë 06.07.2022, bazuar në nenin 162 të ligjit nr.44/2015 datë 30.04.2015 "Kodit të Procedures Administrative të Republikës së Shqipërisë" Dega e Doganës Kapshtice, ka bërë shpallje publike në këndin e njoftimeve të degës për vendimin e sipërcituar, i cili vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes, sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 162.

Në këto kushte në bazë të vendimit të sipërpërmendur të Degës së Doganës Kapshticë, me qëllim për rikuperimin me forcë të borxhit doganor të përcaktuar në Vendimin Nr 92 datë 10/02/2022 që debitori "B BY DC" identifikuar me NIPTM02110023P, ka ndaj Degës së Doganës Kapshticë, në zbatim të nenit 280 të K.Doganor dhe nenit 511 e vijues të K.Pr.Civile

### V E N D O S A Q Ë:

- 1.Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë, sendet me vlerë të cmuar, valutë të huaj të depozituara në bankë, që i përkasin debitorit, personave të tretë apo garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.
- 2.Të sekuestrohen mallrat, pasuritë e turndshme dhe të patundshme që i përkasin debitorit, personavë të tretë apo garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.
- 3.Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri në masën që të bëhet e mundur plotësimi i detyrimeve të mësipërme në masën e përcaktuar në vendimin Nr 92 datë 10/02/2022 si dhe të kamatë vonesave të lindura në bazë të nenit 280 pika 1/b të Kodit Doganor deri në ditën e likuidimit të borxhit doganor.

Kryetari i Degës së Doganës Kapshticë

HERKUL MARKO

